



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2021

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njojur rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si autoriteti përgjegjës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke vlerësuar zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

Duke synuar forcimin e mekanizmave institucionalë të barazisë në shoqëri dhe rolin e tyre për funksionimin e një shoqërie demokratike, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe intolerancë;

Duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, me shoqërinë civile, medien dhe publikun,

**Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2021 në këto drejtime:**

Monitorimin e zbatimit të legjisacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi për individët që i përkasin komunitetit LGBTI, në mënyrë që askujt të mos i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit.

Realizimin e studimit “Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregulator në lidhje me furnizimin me energji elektrike”.

Intensifikimin e bashkëpunimit me aktorët e shoqërisë civile, që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore.

Angazhimin në hartimin e “Kodit të sjelljes së partive politike shqiptare gjatë fushatave zgjedhore”, që përcakton rregulla të qarta të sjelljes për partitë politike, subjektet konkuruese dhe mbështetësit e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në procesin zgjedhor, e cila duhet të garantojë zbatimin e standardeve më të larta demokratike.

Realizimin e botimit “Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi – përbledhje për fëmijë”, në ndihmë të fëmijëve, prindërve, mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, si instrument i nevojshëm në adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe promovimit e barazisë.

Angazhimin për dhënien e rekomandimeve drejtar autoritetëve përkatëse për propozime për ndryshime ligjore ose projektligje të reja.

**Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi për vitin 2022 të angazhohet në këto drejtime:**

- 1 Të intensifikojë aktivitetin ndërgjegjësues për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI për aksesin ndaj kujdesit shëndetësor, arsimit, drejtësisë, punësimit dhe strehimit.
- 2 Të angazhohet veçanërisht në zonat rurale për të nxitur respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe të fokusohet në ndërgjegjësimin mbi gjuhën e urrejtjes, sidomos në kategoritë më të diskriminuara.
- 3 Të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuese në sistemin arsimor të të gjitha niveleve për adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimin kundër gjuhës së urrejtjes.
- 4 Të vijojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit për përcjelljen reciproke të ankesave të bëra nga individët në institucionet respektive apo bashkërendimin e iniciativave të përbashkëta.
- 5 Të bashkëpunojë me AMA-n dhe AKEP-in për qasje proaktive dhe sa më efikase në parandalimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe të dhunës në portalet e ndryshme online.
- 6 Të miratojë “Planin Strategjik 2022-2025”, si një instrument i rëndësishëm ku përcaktohen priorititetet dhe objektivat afatgjatë të institucionit.
- 7 Të dorëzojë pranë Kuvendit një raport analistik në lidhje me shkaqet kryesore të rritjes së ankesave për të kuptuar nëse vijnë si rezultat i forcimit të kapaciteteve të KMD-së dhe rritjes së ndërgjegjësimit qytetar apo si rezultat i rritjes së formave të diskriminimit.
- 8 Të rrisë angazhimin për monitorimin e mbrojtjes nga diskriminimi në sektorin ekonomik privat, si dhe të forcojë kapacitetet për të bashkëpunuar me sindikatat, organizatat e punëdhënësve, organizatat e punëmarrësve, me fokus të drejtat në punë dhe mbrojtjen nga diskriminimi gjinor në sektorin ekonomik.
- 9 Të publikojë statistika periodike për veprimtarinë e zyrate vendore dhe të informojë Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për natyrën e problemeve të konstatuara në nivel vendor.
- 10 Raporti vjetor të përbajë kontributin e KMD-së në lidhje me konstatimet dhe rekomandimet në progresraportin e BE-së për Shqipërinë, si dhe për ecurinë e procesit të përafshimit të legjislacionit shqiptar me direktivat europiane.
- 11 Në funksion të transparencës, të publikojë në faqen zyrtare vendimet gjyqësore dhe të dhëna konkrete për përdorimin e fondeve të përfituar nga donacionet.

Miratuar në datën 30.5.2022